VENDIM
Nr.13, datë 8.2.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SELCA ENERGJI" SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.2.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Selca Energji" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte (neni 17 pika 2 germa "a").
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte (neni 17 pika 2 germa "b").
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) është janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte (neni 17 pika 2 germa "c").
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte (neni 17 pika 2 germa "d").

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Selca.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta